



Informatë për shtyp - 205/03/2020

NRW-Ndihmë e menjëhershme 2020 për biznese të vogla, punëtorë me honorar, solo-biznese dhe themelues të bizneseve të reja në këtë javë

Ministri Pinkwart: Që të arrijnë mjetet shpejt, kemi organizuar një proces të thejeshtë digital und jobyrokratik.

Ministria për ekonomi, inovacion, digitalizim dhe energji njofton:

Me një ndihmë të menjëhershme dhe të pashembulltë po ndihmon federata dhe landi bizneset e vogla dhe të mesme nga të gjitha fushat e ekonomisë si dhe bizneset me një person, punonjësit me honorar si dhe themeluesit e bizneseve të reja në kohën e krizës së koronavirusit. Programi federal i ndihmës së menjëhershme Corona për biznese të vogla ka vendosur një ndihmë prej 9.000 Euro përkatësisht 15.000 Euro. Qeveria e Landit shton këtë program edhe njëherë dhe përkrah bizneset me 10 deri në 50 punëtorë përmes një ndihme të menjëhershme të NRW-it me 25.000 Euro. Që paratë të rrjedhin sa më shpejt tek të prekurit ata mund të shkarkojnë formularët elektrik për aplikim nga e premtja (27. 3.) online në faqen www.wirtschaft.nrw/corona. Formularët do të përpunohen në vikend nga punonjësit e administratës së qarkut

Ministri i ekonomisë dhe digitalizimit Prof. Dr. Andreas Pinkwart: „Shumë biznese të vogla dhe solobiznese kanë pësuar një ulje masive të të hyrave, stornime të shumta të projekteve. Ata nuk e din, se si t'i paguajnë shpenzimet fikse si qiranë, këstet e leasingut dhe këstet e kredisë. Për këtë arsye e shtojmë së bashku me federatën një ofertë të përkrahjes së menjëhershme për ndihmë të shpejtë të bizneseve të vogla dhe solo-bizneseve në mënyrë që të mbijetojnë këtë kohë financiarisht dhe të ruajnë vendet e punës. Për të arritur shpejt këto mjete të nevojshme ne kemi organizuar procesin e aplikimit në mënyrë të thjeshtë, të holluar dhe jobyrokratik.“

Bizneseve të vogla, anëtarëve të profesioneve të lira, themeluesëve të bizneseve dhe solo-bizneseve u garantohet kjo përkrahje për mënjanimin e problemeve financiare në tre muajtë e ardhshëm:

- 9.000 Euro: deri në pesë punonjës (mjete nga federata)
- 15.000 Euro: deri në dhjetë punonjës (mjete nga federata)
- 25.000 Euro: deri në pesëdhjetë punonjës (mjete nga landi)

Këto kushte duhet të plotësohen:

Biznesi duhet të kenë qenë në aspektin ekonomik i shëndosh qysh para krizës. Si pasojë e krizës së koronës

- të hyrat në krahasim me muajin e njëjtë të vitit të kaluar janë më shumë se përgjysmuar
- ose mjetet e poseduara nuk mjaftojnë për të plotësuar detyrimet e përkohshme financiare të biznesit (p.sh. qiraja, kreditet për lokalin e biznesit, këstet e leasingut),
- ose veprimtaria e biznesit është mbyllur me urdhëresë zyrtare.

Landi i ifron biznesve një mori ofertash. Këtu numërohen:

- Sigurimet: Në Nordrhein-Westfalen i ofrojnë banka e sigurimeve - Bürgschaftbank NRW- (deri në 2,5 milion Euro për biznes) dhe programi i sigurimeve të landit -Landesbürgschaftsprogramm- (nga 2,5 milion. Euro) për t'i siguruar kreditë. Banka e sigurimeve - Bürgschaftsbank- mundëson një sigurim ekspres prej 72 orësh.
- Banka e sigurimeve -Bürgschaftsbank-: Për gjyrollogarinë rrjedhëse do t'i ofrojmë deri në 100.000 Euro përmes bankës së sigurimeve - Bürgschaftsbank NRW- 90 përqind në një proces të shpejtë me përpunim të lëndës brenda një dite menjëherë pasi të mirret leja nga ministria federale e financave.
- Kreditet e KfW-së: Kamata të ulëta dhe një provim i thjeshtë i rrezikut të kredisë nga KfW për kreditë deri në 3 milion Euro japin lehtësime tjera për ekonominë. Një lirim nga detyrimet përmes KfW deri në 90 përqind për mjetet e veprimtarisë biznesore due investimet e bizneseve të vogla dhe të mesme i lehtësojnë dënien e kredive nga bankat dhe kucat e kursimit (Sparkassen).
- Shtyrjet tatimore: Administrata e tatimeve i ndihmon bizneset e prekura nga kriza përmes kërkesës nga tatimet e detyruara pa llogaritur kamatën (të hyrat personale-, tatime mbi korporata dhe tatimi mbi vlerën e shtuar dhe ngrirjen e parapagesave tatimore dhe taksën e biznesit) dhe shfrytëzon edhe më tej hapësirën e lëvizjes për detyrimet tatimore. Për mundësinë e aplikimit është në dispozicion një formular shumë i thjeshtë.

- Dëmshpërblimet për ata që janë në karantenë: Poqëse është urdhëruar një ndalesë e veprimtarisë për shkak të koronavirusit mund të kërkohet bizneset një dëmshpërblim për pagesat e pagave për punëtorë tek shoqatat e landit Rheinland dhe Westfalen-Lippe.
- Kapitali pjesëmarrës për bizneset e vogla: Fondi i gjermanisë „Mikromezzaninfonds Deutschland“ mund të sjell pjesëmarrje të qetë pa e konsultuar bankën e biznesit dhe pa sigurime (maksimal 75.000 Euro). Parashihet për bizneset e vogla, themelimet e bizneseve të reja dhe grupeve speciale (pos tjerash bizneset që arsimojnë të rinjtë si dhe themelimet e bizneseve nga të papunët).

Një paraqitje të instrumenteve financiare për të gjitha bizneset si dhe punonjësitë përgjegjës i gjeni në portalin tonë të informacioneve, që vazhdimisht aktualizohet: <https://www.wirtschaft.nrw/corona>

Zyra e shtypit:

Matthias.Kietzmann@mwide.nrw.de, 0211-61772-204

Ky tekst i shtypit mund të gjendet përmes faqes së internetit të qeverisë së Landit www.land.nrw

[Udhëzime lidhur me mbrojtjen e datave lidhur me mediat sociale](#)



Informatë për shtyp - 199/03/2020

Katalogu i miratuar i dënimeve penale dhe me gjobë për realizimin e ndalimit të kontakteve

Qeveria e Landit informon:

Për realizimin e ndalimit të kontakteve qeveria e Landit ka botuar një katalog të dënimeve penale dhe me gjobë për realizimin e ndalimit të kontakteve. Bazë e tij është ligji për mbrojtjen nga infektimet. Me këtë do të mënjanoen infektimet dhe do të ngadalësohet përhapja e koronavirusit.

Kryetari i qeverisë së Landit Armin Laschet: „Situata është serioze. Fjala është për jetë ose vdekje. Ndalimi i rrepë i kontakteve do të ndihmojë me siguri në reduktimin e rrezikut të përhapjes. Shumica e njerëzve për fat të mirë i respektojnë rregullat dhe tregohen solidar. Ne nuk ka nevojë t'i kontrollojmë të arsyeshmit, por t'i dënojmë të paarsyeshmit. Edhe atë konsekuent dhe rreptë. Sinjalet duhe t'i arrijnë ata. Tolerancë zero vlen edhe për ata që i thejnë rregullat në luftën kundër koronavirusit.“

Katalogu përmban një paraqitje përmbledhëse mbi shkeljet e ligjit si vepra penale dhe shkeljet e ligjit me gjobë (kundërvajtje). Vepër penale shkaktojnë, ata që vinë p.sh. nga rajonet e rrezikuara dhe me qëllim ose nga pajkudësia p.sh përkundër ndalesës së hyrjes hyjnë në shtëpitë e pleqëve. Si vepër penale vlejné poashtu tubimet në publik, të të cilat marrin pjesë më shumë se dhjetë persona. Kush organizon me dashje ose nga pakujdesia takime ose tubime publike përkundër rregullës së ndalimit të kontakteve shkakton poashtu vepër penale. Edhe për këtë janë numëruar shkeljet e ligjit dhe dënimet e parapara për to.

Ministri i brendshëm Herbert Reul: „Kemi të bëjmë me dënime të rrepta. Por kush nuk dëshiron të dëgjoj duhet të paguaj ose hiqet nga qarkullimi. Fjala nuk është këtu për diçka të vogël, por për shëndetin dhe jetën e miliona njerëzve. Entet për mbajtjen e rregullit si dhe polizei do të marrin masat e duhura, por edhe do të realizojnë ato shumë rreptë.“

Tek shkeljet ligjore bëjnë pjesë p.sh. pikniqet dhe skara në publik. Për këtë është i paraparë dënimi prej 250 Euro. Në rast takimesh prej më shumë se dy persona, por më pak se dhjetë persona çdo person duhet të paguaj 200 Euro. Kush shkel ligjin dhe viziton dikend në shtëpitë e pleqëve ose në spital duhet të paguaj 200 Euro. Këto dënime vlejné si dënime të para. Në raste të veçanta ato dyfishohen. Në rastet e përsëritjeve mund të shqiptohen dënime deri në 25 000 Euro.

Ky tekst i shtypit mund të gjendet përmes faqes së internetit të qeverisë së Landit www.land.nrw

[Udhëzime lidhur me mbrojtjen e datave](#)



Informatë për shtyp - 201/03/2020

Parlamenti i Landit miratoj një paketë financiare pas buxhetore për krizën e koronavirusit

U vendos paketa ligjore me votat e të gjitha fraksioneve / ministri Lienenkämper: Paketa financiare e NRW-it mundëson një zgjidhje përkatëse, me masë të caktuar dhe jobyrokratike për situatën aktuale të atyre që janë të prekur nga kjo krizë në Landin tonë.

Ministria e Financave informon:

Parlamenti i Landit të Nordrhein-Westfalen-it ka miratuar sot me votat e të gjitha fraksioneve ligjin për instalimin e një fondi të veçantë. Ky ligj i paketës financiare të NRW-it u miratua ligji për buxhetin shtesë për vitin 2020. Me këtë ligj është në dispozicion një shumë deri në 25 miliardë Euro për të zbutur pasojat direkte dhe indirekte të krizës së koronavirusit.

Të martën e kaluar kryetari i qeverisë së Landit NRW Armin Laschet, ministri i financave Lutz Lienenkämper dhe ministri i ekonomisë prof. dr. Andreas Pinkwart paraqitën në kornizat e takimit të parë të lartë ekonomik të qeverisë së Landit Nordrhein-Westfalen planin për paketën financiare lidhur me koronavirusin. Pas vendimit të kabinetit qeveritar të shtunën e kaluar u miratua ky ligj paketor në leximin e parë deri në leximin e tretë me përfshirjen e komisioneve për buxhet dhe financa në parlamentin e Landit NRW.

„Unë falënderoj të gjitha fraksionet prezente, që edhe në këtë orë fati për buxhetin dhe financat e Landit e miratuan këtë paketë ligjore“, tha Lienenkämper. „Paketa financiare e NRW mundëson një zgjidhje përkatëse, me masë të caktuar dhe jobyrokratike për situatën aktuale të atyre që janë të prekur nga kjo krizë në Landin tonë. Me këtë edhe paguhet, që ne arrijmë të krijojmë një kthesë në buxheti, që ne na mundëson një fleksibilitet përkatëse në situatën aktuale“.

Paketa ligjore përfshin këto masa të menjëhershme:

- Ndhimat për ekonomi përmes një lehtësimit të kornizave të kredive (ligji i paketës financiare të NRW): Edhe kornizat e sigurisë së kredive për ndihmat ekonomike u shtuan nga 4,1 miliardë Euro në 5 miliardë Euro. Edhe kornizat për sigurinë e kredive është rritur nga 900 milionë deri në një miliardë Euro.
- Ministria e financave autorizohet, që të liroj NRW.BANK-ën nga detyrimet e përgjithshme të programit univerzal të kredive deri në një shumë prej 5 miliardë Euro.
- Ndhimat për bizneset e vogla dhe bizneseve me një person (ligji i paketës financiare në NRW): Garancia për ndihmat e menjëhershme mundësohet edhe si shtesë e programeve federale nga buxheti për grupet e prekura. Bizneset e vogla me 10 deri në 50 të punësuar mund të marrin një ndihmë deri në 25.000 Euro. Poashtu Landi Nordrhein-Westfalen do të jap sa më shpejtë ndihmat e menjëhershme të federatës për bizneset e vogla dhe bizneseve me një person.
- Marrja e kredive dhe dhënia e mjeteve (buxheti shtesë 2020): marrja e kredive si pasuri e veçantë pason në koste në varësi nga shpenzimet e nevojshme. Departamentet përgjegjëse në kornizat e masave individuale i shpenzojnë mjetet për planet individuale. Shpenzimeve të parapara nga qeveria e Landit u nevojitet miratimi i komisionit për buxhet dhe financa të parlamentit të Landit, nëse miratimi i tij me kohë arrihet lidhur me urgjencën dhe nevojën e shpejtë të shpenzimeve me kohë

Formularët për aplikim lidhur me lehtësimet e tatimeve për shkak të ndikimeve nga konavirusi mund të shkarkohen nga kjo faqe e internetit www.finanzverwaltung.nrw.de.

Informacionet dhe personat përgjegjës për firmat e prekura mund të gjenden në faqen e internetit www.wirtschaft.nrw.de.

Rekomandohet përcjellja e faqes sonë në internet:

Twitter: [@Finanzmin_NRW](https://twitter.com/Finanzmin_NRW) **YouTube:** [Finanzverwaltung NRW](https://www.youtube.com/Finanzverwaltung_NRW)

[Udhëzime lidhur me mbrojtjen e datave lidhur me mediat sociale](#)

Në rast të pyetjeve drejtoheni në zyrën e shtypit të ministrisë së financave, telefon 0211 4972-2784.

Ky tekst i shtypit mund të gjendet përmes faqes së internetit të qeverisë së Landit www.land.nrw